



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112101-16666  
Datë: 24.08.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 20 paragrafi 3 të Ligjit numër 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe nenin 33 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Sektorin për Shërbime të Përbashkëta, mori këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi **Hysen Brahimaj**, i sistemuar në punë Zyrtar i Lartë për Arsim në kuadër të Drejtorisë për Arsim, **caktohet zëvendësues i Udhëheqësit të Sektorit për Shërbime të Përbashkëta**, që të punoj me kompetenca të plota, sipas koeficientit **7.26 (GJ3)** duke filluar nga data **01.09.2023**.
2. I emëruari si në piken 1 të këtij vendimi, ushtron detyrat dhe përgjegjësitë si më poshtë:
  - 2.1. Udhëheqë punën e gjithmbarshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave.
  - 2.2. Menaxhon me stafin e sektorit dhe bënë ndarjen e detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore.
  - 2.3. Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë.
  - 2.4. Menaxhon dhe organizon punën e zyrtarëve për ndërtimtari dhe infrastrukturë, zyrtarëve ligjor, zyrtarëve për statistika, zyrtarëve të pasurisë dhe zyrtarëve për buxhet dhe financa në kuadër të Drejtorisë për Arsim.
  - 2.5. Kontribuon në procesin e vendimmarrjes, sipas fushës së përgjegjësisë duke siguruar të dhëna të detajuara dhe analiza të cilat mbështesin procesin e vendimmarrjes.
  - 2.6. Siguron koordinimin e aktiviteteve me sektorët tjerë të Komunës së Gjakovës për të siguruar efikasitet dhe zbatim të drejtë të proceseve të punës.
  - 2.7. Bën vlerësim të rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**Vendimi iu dorëzohet:**

- Nëpunësit Hysen Brahimaj
- Drejtorisë për Arsim
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

**Ardian Gjini**  
  
Kryetar i Komunës së Gjakovës